



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

**01Nr.104/02-16334**

## **PROCESVERBAL:**

Dëgjim buxhetor:

Buxhetin për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026 me qytetarë të Komunës së Kaçanikut

Data: 04.08.2023

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora: 14:00

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e cila ka hartuar draft buxhetin për vitin 2024, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pikë 1.6 të Udhëzimit Administrativ ( MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna,, organizoi dëgjim buxhetor me qytetarë të Komunës së Kaçanikut

Takimin hapi nënkyetari i Komunës Sabedin Vishi, i cili falenderoi dhe njëkohësisht inkurajoi qytetarët që të marrin pjesë në dëgjimet publike, sepse në këtë mënyrë ato bëhen pjesë e vendimmarrjes së përbashkët komunale, si dhe caktimi i prioriteteve investuese është më i lehtë kur merren vendimet e përbashkëta.

Më pas nënkyetari Vishi shpalosi të dhëna nga projekt buxheti për vitin 2024, i cili do të jetë afër 12 milion euro ( 11,958,983.00), të cilat mjete më pas do të shpenzohen sipas kategorive të parapara buxhetore.

**Hajredin Luta-** banor i fshatit Ivajë

Pse janë ndërprerë punimet në rezervuarin në Ivajë, ka mbetur një projekt gjysmak. Pse ka mbetur pa u shtru e gjithë rruga me zhavorr te zmakt, poashtu kërkoj ndriçim publik të rrugës. Kanalizimi është finalizu me letra, por punët në terren kanë mbetur të pa miratuara.

**Nexhmedin Lika-** kanë mbetur të pa shtruara dy rrugica në Shtrazë.

**Rrustem Zenuni- asmableist-** Vitin e kaluar kam insistuar për ndërtimin e trotuarit tek Fusha e Pajtimit deri tek restoran Natyra, ky eshte një prioritet i banorëve të kësaj ane. Vazhdim i trotuarit rruga “ Hetem Hasaj”. Rruga Lokale Gërlicë- gabricë të rregullohet, poashtu të rregullohet terreni sportiv Duraj afër xhamisë.

Fadil Vishi- Kryetar i Këshillit të fshatit Dubravë- Ndërtimi i fabrikës për ujë në Sepetin, të jetë prioritet pasiqë po ka probleme me ujë të pjes.

Shtrirja e ujësjellësit në Lagjen Vatë, rregullimi i parkut dhe shtratit të rekës së fshatit. Kërkoj të rregullohet trotuari dhe ndriçimi prej lumit Lepenc deri tek Varrezat e fshatit si dhe nga shkolla deri tek Lagija Kamish.

Rregullimi i trasesë lagjja Imisht- Dullovi, rruga “ Fetije Qorri”. Poashtu kërkoj që të ndahet një parcelë për varrezat në Dubravë.

**Fatmir Qaka- banor i fshatit Bob** - Të rregullohet rezervuari i ujit të pjes, sepse kur ka shumë ujë, ai del jashtë dhe nuk shfrytëzohet, poashtu kërkoj të mbylljet një pusetë e hapur nga Bifurkacioni, sepse është rrezik për kalimtarë.

**Ibrahim Dalloshi**- Kryetar i këshillit Doganaj-Të caktohet një lokacion për rregullimin e fushës së sportit, ndërsa më pas mundemi edhe vet si qytetarë ta rregullojmë. Të rregullohet rruga Bob- Doganaj, dimrit të mirëmbahet, poashtu kërkoj që të kontrollohen projektet në terren, sidomos projektet e bujqësisë, si dhe dua të informohen se kur planifikohet të hapet ambulanta e re në Doganaj?

### **Kadri Dardhishta- kryetari i këshillit të zonës urbane 1**

Të rregullohet një shkarpë në rrugën “ Avdurrahim Shehu” rruga “ Kjani Bela” të rregullohet.

### **Azem Koraqi- Kryetari i Këshillit të Fshatit Kovaqec**

Të rregullohet qatia e shkollës, sepse objekti i ri po pik gjatë të reshurave, kanali i ujitjes ka mbetur në gjysmë, një pjesë e kanalizimit po kemi probleme, faji është i yni por kërkojmë ndihmën e komunës për intervenim.

